

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE - SHOQERIA AUTOELITE SHPK

Shoqeria AUTOELITE SHPK ka qene i pajisur me Leje Mjedisore te tipit C me nr. Identifikimi 46 date 22.01.2015, por per shkak te ndryshimeve ligjore ne Ligjin Nr.10 448, datë 14.7.2011 "Për Lejet E Mjedisit", i amenduar ne Ligin nr. 52/2020, datë 30.4.2020 eshte riklasifikuar per tu pajisur me Leje Mjedisore Tipi B dhe informuar nga shkresa e dërguar nga DRM Lezhe. Te gjitha instalimet dhe procedurat e punës nuk kane ndryshuar. Shoqeria AUTOELITE SHPK me qendër ne Bushat, Shkoder me aktivitet servis automjetesh dhe Ringjyrosje ose risprucim i mjeteve të transportit rrugor ose pjesëve të tyre.

Për impiantin/instalimin:

- 1. Titulli i instalimit :** Riparim i pajisjeve motorike dhe motoçikletave. Ringjyrosje ose risprucim i mjeteve te transportit rrugor ose pjese te tyre
- 2. Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues :** Riparim i pajisjeve motorike dhe motoçikletave. Ringjyrosje ose risprucim i mjeteve te transportit rrugor ose pjese te tyre. Siperfaqja e Truallit 4500 m², Siperfaqja e Objektivit 1256 m²

Shoqeria Autoelite shpk zbaton normat ligjore gjate mbarëvajtjes se punës dhe te gjitha instalimet/ pajisjet janë me dokumentacionin respektiv . Ne ambientet e punës respektohen normat ligjore dhe mirëmbahet mjedisi i punës.

Shoqeria Autoelite shpk ka kryer vetemonitorimin per zbatimin e kushteve mjedisore duke zbatuar legjislacionin mjedisor sipas Lejes Mjedisore tipi C , nëpërmjet subjektit QMM- Qendra e Monitroit te Mjedist ne muajin shkurt 2020 dhe e ka dorëzuar pranë DRM Shkoder

Rezultatet e monitorimit kane qene brenda parametrave te kërkuara nga legjislacioni shqiptane përmbushje te zbatimit te normave te përcaktuara ne Lejen Mjedisore te tipit C.

Ne lidhje me menaxhimin e mbetjeve te vajit shoqëria ka lidhur kontrate me kompaninë Amos Oil shpk me nr identifikimi NIPT K87508801F, e pajisur me Leje Mjedi tipi A per shërbimin -Grumbullimin, Transportin e vajrave te përdorura dhe mbetjeve hidrokarbure, ne 15/08/2019 me nje afat 2 vjecar.



Gjithashtu, mbetejet e skrapit, hekurishtet ne momentin kur ka gjendje merren nga kompania qe merret me mbledhjen e hekurishteve.

Gjate gjithë kohës se punës kur shoqëria ka qene e pajisur me Leje Mjedisori Tipi C, nuk ka patur ndryshime ne teknologjinë apo instalimet ne ambientet e kompanisë AUTOELITE shpk.

Gjate periudhës se shërbimit nuk janë regjistruar aksidente te ndryshme ne ambientet e punës.

Gjate gjithë kohës personeli i cili punin ne oraret 8:00-17:00 eshte informuar mbi kushtet e lejes mjedisore dhe normat qe duhet te zbatojnë gjate punës se tyre te përditshme.

Servisi ka disponibel 3 pedana (ura ngritese) dhe 3 pedana (ura konvergjence), 1 ure konvergjence drejtim shasie, dhe zonen per lyerje karrocierie. Servisi kryen sherbimet kryesore si nderrim vaj e filtra , nderrim pjese dhe antifrizet per sistemin e ftohjes , nderrim pjese dhe alkool freni te sistemit te frenimit, nderrim te pjeseve xhenerike dhe sistemit te drejtimit , nderrim te gomave, konvergjence te gomave, nderrim te amortizatoreve dhe suporteve te tyre , nderrim te pjeseve te sist te ndezjes dhe furniz me karburant te mjetit , riparim shasie dhe lyerje (sprucim) te karrocierise. Dy jane sherbimet kryesore qe kryhen ne servis – Autoriparim i automjeteve dhe Lyerje (sprucim) i karrocierise se automjeteve .

Servisi perdor materiale qe nderrohen (vaj lubrikant , filtra, gomina pjese te ndryshme, amortizatore , alkool freni, antifrizet etj) ose materiale ndihmese qe nevojiten ne punen e perditshme (graso, vaj lubrikant per pajisje, gaz per mjetet, bojra dhe aditive te tyre, materiale te ndryshme ndihmese per punen e bojatisjes).

Vajrat e perdorur merren ne dorezim nga kompania qe merret me trajtimin e tyre me te cilet kemi nje kontrate. Materialet e tjera ndahen ne dy pjese materiale plehra (qe terhiqen nga sherbimi i Terheqjes se Plehrave te Bashkise dhe materialet hekurishte qe terhiqen nga firma qe merret me mbledhjen e hekurishteve. Ne Ambient nuk hidhet asnjë mbetje qe gjenerohet.

Materialet jane te paketuara e te mire menaxhuara dhe nuk ka rrjedhje apo kontaminim te ambienteve te punës.



Konsumi i ujit eshte me shpim pasi nuk ka rrjet ujësjellësi, dhe kemi nje konsum 100m³/muaj.

Asnje substance e rrezikshme apo jo te rrezikshme nuk derdhet, shkarkohet ne ujerat pritëse siperfaqesore apo ne kanalet publike. Per vete natyrën e punës se servisit nuk perdoret uje dhe nuk kemi gjenerim te ujit teknologjik.

Ujerat e shiut janë ato te vetëm te cilat shkarkohen ne kanalin e komunës ne afërsi te pronës dhe servisit por qe nuk ndikojnë negativisht ne mjedis.

Ujerat e tualeteve/te përdorimit personal per shkak te mos pasjes se kanalizimeve te ujerave te zeza ne vendndodhjen e aktivitetit depozitohen ne gropën septike e cila pastrohet ne momentin e nevojshëm.

Pra nga aktiviteti i kompanisë nuk ka ndikime ne ujerat siperfaqesore dhe nentokesore te zonës

Konsumi i Energjise vete afërsisht 4500 kw ne muaj ose rreth 54.000 kw ne vit. Instalimet dhe pajisjet e punës nuk shkaktojnë shkarkime te PM ne ajër. Dha nuk ka shkarkime ne toke.

Jane kryer matjet e nivelit te zhurmave nga subjekte te licensuar dhe niveli i zhurmave eshte brenda normave te lejuara. Aktiviteti i shoqërisë nuk shkakton vibracione gjate punës.

Jane kryer matjet e nivelit te zhurmave nga subjekte te licensuar dhe niveli i zhurmave eshte brenda normave te lejuara. Gjate aktivitetit te operimit te subjektit janë monitoruar niveli i zhurmave:

- Niveli i zhurmave ne mjediset e jashtme (ne perimetër te servisit)
- Niveli zhurmave ne hyrje te servisit

Kohezgjatja e matjes ka qene 30 min me aparature soundmeter delta OHM HD 2010 UC sipas standartit SSH EN ISO/DIS1996-2:20005.

Niveli i zhurmave ne servis ka rezultuar ne parametrat 64 dB (a) LA eq dhe 85 dB (a) LA max

Niveli i zhurmave ne perimetër te servisit ka rezultuar ne parametrat 66 dB (a) LA eq dhe 81 dB (a) LA max

	Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4)	Niveli i zhurmës /dB(A)	
		L(A) _{eq}	L(A) _{max}



Ambientet e instalimit				
Vendndodhja 1:	4378642.09	4651857.9	64	84
Vendndodhja 2:	4378668.83	4651871.62	66	81
Vendndodhja 3:				
Vendndodhja 4:				

Rekomandimet :

Shkarkimet te cilat mund te përmirësohen eshte lidhja me sistemin e kanalizimeve te ujerave te tualeteve/ te përdorimit vetjak ne momentin qe do te ndërtohet rrjeti i kanalizimeve ne zonën e njësisë administrative ku operon shoqëria.

Gjate periudhës se punës do te kontrollohen dhe përmirësohen aparaturat per te ulur nivelin e zhurmave, edhe se nga monitorimet eshte konstatuar nen nivelin e lejuar.

Gjate procesit te punës nuk kemi përdorime te ujit dhe si pasoje nuk kemi as shkarkime te ujerave teknologjike.




Menaxhimi i mbetjeve kryhet dhe do te vazhdoje te kryhet ne baze te legjislacionit shqiptar. Cdo mbetje qe gjenerohet nga aktiviteti i kompanisë, grumbullohet , trajtohet/ asgjësohet duke zbatuar normat e lejuara.

Mbetjet e Vajit te hequra nga makinat depozitohen ne fuçitë e vendosura dhe te etiketuara "Vaji i përdorur " dhe tërhiqen nga firma e kontraktuar dhe e licensuar per te kryer kete proces ne baze te kontratës se lidhur me te.

Aktiviteti gjeneron mbetje te ngurta me karakter urban/ ambalazhi, te cilat pasi mblidhen ne qese hidhen pranë kontenitoreve te përcaktuar nga pushteti vendor. Subjekti eshte pagues i rregullt i taksave, si ajo e pastrimit te lëshuar nga Bashkia Shkoder.

Mbetjet e skarpit depozitohen ne sipërfaqen e oficinës dhe merren nga firmat e licencuar per te kryer procesin e trajtimit/asgjësimit te tyre.







<https://geoportal.asig.gov.al>: ofron të dhëna gjeohapësimore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.

Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH


	Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4		KRGJSH	
	E	N	E	N
1	4378667.43	4651881.61	461399.81	4650815.17
2	4378692.52	4651847.78	461425.29	4650781.64
3	4378635.17	4651804.96	461368.45	4650738.17
4	4378599.88	4651840.95	461332.75	4650773.73



ANIMETRIA E OBJEKTIT: SERVIS I PERGJITHSHEM I AUTOMJETEVE
S= 1 256m².

IND DODHJA: FSHATI KOSMAÇE NJ.A BUSHAT
BASHKIA VAU DEJES.

DNARI: AUTOELITE sh.p.k
MINISTRATOR:BUJAR KODRA



OBJEKTI: SERVIS I PERGJITHSHEM I AUTOMJETEVE. FSHATI KOSMAÇE NJ.A BUSHAT BASHKIA VAU DEJES	TË DHË ZK 2231 SIP= 4 :
--	-------------------------------

